



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 501, datë 26.10.2020

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT
Z.{...}, PËR GJYKIMIN E NJË ÇËSHTJEJE GJYQËSORE NË GJYKATËN E
POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E
ORGANIZUAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, të pikës 4 dhe në pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 13, të Vendimit të tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dërguar me Shkresën nr.1062, prot., datë 21.10.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr.5418, datë 23.10.2020, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me me kërkues: Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; të pandehur: {...}, {...}, {...} dhe {...}; akuza: “Nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2, 334/1.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR